

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Kurbin

Data: 29.08.2025

Ora: 11:00

Mbledhja drejtohet nga: Marjana Gjini, nënkryetare e Këshillit

Të pranishëm: 20 këshilltarë

Pjesëmarrës nga administrata:

- Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë
- Jurgena Tuci, Drejtorja e Burimeve Njerëzore
- Rake Kola, Drejtorja e Financave
- Bardha Pojani, Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Mirëdita të nderuar këshilltarë. Si jeni në dijëni, Arbri, sekretari i këshillit, ka pasur një fatkeqësi familjare dhe nuk mund të jetë sot i pranishëm në mbledhje. Në bazë të ligjit, rolin e sekretarit e merr këshilltari më i ri. Kush është më i ri këtu, mes Melisë, Diogjenit dhe Deas?

Diogjen Kolici, këshilltar: Nëse më lejoni, e kryej unë rolin e sekretarit në mungesë të Arbrit.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Atëherë hedhim këtë në votim. Kush është dakord që sot Diogjeni të zëvendësojë Arbrin?

Votimi: Miratohet.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Diogjen, të lutem, merr vendin e sekretarit. Vazhdojmë me mbledhjen.

Miratimi i rendit të ditës:

Rend i Ditës:

1. Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% për muajin Korrik 2025.
2. Projekt-vendim për miratimin e nivelit të qirasë mesatare për vitin 2026.
3. Projekt-vendim për miratimin e marrëveshjes (tip) për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Bashkisë dhe Ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore, për zhvillimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA).

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Siç jeni në dijëni, krahas axhendës së ardhur te ju, Kryetarja e Bashkisë ka propozuar që të futen në rendin e ditës edhe dy projekt-vendime të tjera:

Projekt-vendimi për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Kurbin dhe Projekt-vendimi për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar. Fjala për ju, Kryetare.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Mirëdita të gjithëve. Duke ju kërkuar ndjesë për sjelljen me vonesë të projekt-vendimeve, ju shpjegoj arsyet pse ka ndodhur kjo. Ne po përgatiteshim që këto projekt-vendime të ishin të gatshme për mbledhjen e shtatorit, por në kuadër të Grantit të Performancës na u kërkuua që këto plane të miratoheshin para datës 15 shtator, në mënyrë që të përfshiheshin te granti i performancës. Duke qenë se një pjesë e këshilltarëve kanë qenë në dijeni të këtyre planeve, si pjesë e grupeve të punës gjatë dëgjësave publike të mbajtura, i sollëm sot, duke punuar me kohë të zgjatur, në mënyrë që të mos jemi të detyruar të kërkojmë mbajtjen e një mbledhjeje tjetër jashtë radhe në fillim të shtatorit.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Kush është dakord për futjen në rendin e ditës së këtyre dy projekt-vendimeve? Ok. Miratohet rendi i ditës me shtesat. Vazhdojmë me miratimin e projekt-vendimeve.

Procesverbal: *Rendi i ditës u miratua me 18 vota pro, 1 vota kundër dhe 0 abstenime. Nuk u paraqitën kërkesa për diskutim apo argumentim të votës kundër.*

1. “Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj Korrik 2025”.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: si çdo muaj, pika e parë e rendit të ditës është miratimi i ndihmës ekonomike. Ka diskutime? Jo. E hedhim në votim. Miratohet.

Projektvendimi u miratua me 18 vota pro, 1 vota kundër dhe 0 abstenime. Nuk u paraqitën kërkesa për diskutim apo për argumentim të votës kundër.

2. “Projekt-vendim për miratimin e nivelit të qirasë mesatare për vitin 2026.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: pika tjetër e rendit të ditës është Miratimi I nivelit të qerasë mesatare për vitin 2026. Edhe kjo është një pikë që do të ndihmojë bashkinë në llogaritjen e shpenzimeve për ndihmën sociale ndaj familjeve në nevojë për vitin në vijim. Të gjithë jemi të njohur me dokuemntacionin përkatës që është në dosje. Ka diskutime? E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër? Miratohet.

Projektvendimi u miratua me 18 vota pro, 1 vota kundër dhe 0 abstenime. Nuk u paraqitën kërkesa për diskutim apo për argumentim të votës kundër.

3. “Projekt-vendim për miratimin e marrëveshjes (tip) për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis bashkisë dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore për zhvillimin e kapaciteteve të njesive të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë, akademia e trajnimit të njesive të vetëqeverisjes vendore të Shqipërisë (Talga).

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Projekt vendimi I rradhës është miratimi I marrëveshjes tip për krijimin e akademisë së qeverisjes vendore. Ftojme kryetaren të relatojë këtë pike.

Jurgena Tuci, Drejtorja e Burimeve Njerëzore: Atëherë besoj se secili prej jush është njohur me një projektvendimin për miratimin e marrëveshjes tip për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta ndërmjet Bashkisë Kurbini dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore. Konkretisht kjo konsiston në krijimin e një akademie e cila quhet Talga, që ka të bëjë më shumë me trajnimin e punonjësve, punonjës me kod pune, me status nëpunës civil, gjithë aparati i bashkisë, anëtarët e këshillit dhe të gjithë këto. Kjo marrëveshje është bazuar te Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, te Kodi Civil, te ligji për vetëqeverisjen vendore, ligji për organizatat jofitimprurëse, si dhe një vendim që ka dalë së fundi i Këshillit të Ministrave numër 405 datë 16.7.2025, për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore, për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e këtij personi juridik. Pra, Talga e cila është edhe në dobinë tonë, sepse do shërbejë për me trajnuar të gjithë stafet e bashkisë. Tani objekti i këtij projektvendimi ka disa pika dhe kryesori është krijimi i mundësive për ushtrimin e përgjegjësisë ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut dhe zbatimin e strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2023-2030 dhe aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfida dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjithashtu ju kemi paraqitur edhe një relacion me disa faqe, besoj mund ta keni lexuar gjithsecili, në qoftë se keni ndonjë pyetje ose paqartësi se në çfarë konsiston krijimi i kësaj laurimi, kësaj gjëje si të thuash.

Laurin Sana, këshilltar: Faleminderit zonja kryetare, pyetja ime është, e kam lexuar, është romani i tërë, domethënë që është e shkruar, më duket sikur janë ndërruar fjalët nga fjalia në fjali, ajo që nuk jam i qartë përveç pjesës së trajnimit që mund të jetë diçka shumë e mirë. I merret ndonjë kompetencë tjetër bashkisë nga lart në vendimmarrje, nuk e kam kuptuar këtë pjesën, përveç pjesës së trajnimit të punonjësve ose të gjithë përfaqësuesve të bashkisë.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Atëherë shkurt që ta përmbledh dhe unë çfarë konsiston krijimi i akademisë ose Talga shkurt. Këshilli i Ministrave autorizon ministrin për pushtetin vendor për krijimin e kësaj akademie, ku pjesë e kësaj akademie përveç bashkive janë edhe këshillat e qarqeve. Këshilli bashkiak, i cili autorizon kryetarin e bashkisë dhe sot është për njohje të aktit të themelimit edhe të marrëveshjes dhe këshilli bashkiak autorizon kryetarin e bashkisë që të kryejë funksionet për lidhjen e kësaj marrëveshje dhe të jetë pjesë e bordit të

krijimit të Talgës. Është një akademi që do ngrihet për trajnimin e punonjësve kundrejt edhe kryesisht për përafrimin e ligjit kundrejt Bashkimit European, në fusha të ndryshme, duke qenë se nga bashkitë kërkesa ka qenë e madhe për burimet njerëzore se nuk i kemi të mirë trajnuara në fusha të ndryshme dhe kryesisht në pjesën e prokurimeve, kryesisht në pjesën e pyjeve, të financave e të tjerë. Dhe u hodh një mendim që të krijohet një akademi në llojin e organizatës jofitimprurëse pra OJF-së ku ministri përgjegjës për pushtetin vendor autorizohet nga Këshilli i Ministrave dhe para pak kohësh me datë 23 mos gaboj, financat të më korrigjojnë, ne kemi miratuar edhe një buxhet në bazë të shkresës që ka ardhur nga ministri për pushtetin vendor, buxhet nga bashkia i vënë në dispozicion të kësaj akademie. Është thjesht një akademi për trajnimet, ky do të konsistojë me bord, me asamble, do ketë një kod bashkia që do paguajë në regjistrimin si anëtare e Talgës. Përfaqësues për Bashkinë në Talga i kërkohet këshillit që të autorizojë të jetë kryetari i bashkisë siç janë të gjithë kryetarët e bashkive, sot e kanë kaluar të gjitha bashkitë këtë.

Aida Skeja, këshilltare: Kryetare seance, Kryetare e Bashkisë, të nderuar kolegë! Faleminderit që më dhatë mundësinë të flas. Unë kisha përgatitur 10 pyetje, dhe disa prej tyre i ezauroi kryetarja e bashkisë. Por, në lidhje me projektvendimin, unë dëshiroj të shtoj disa pyetje, pasi, përveç efekteve pozitive, mendoj se ka edhe disa rreziqe të mundshme. Pse është krijuar një subjekt i veçantë juridik? Pse po krijohet një subjekt i veçantë juridik (TALGA) kur ne tashmë kemi struktura dhe kemi realizuar trajnime për punonjësit e bashkisë? A nuk do të ishte më efikase të vazhdonim me strukturat ekzistuese? Kostoja dhe ndikimi financiar Më herët u përmend një kuotë prej 400 mijë lekësh të reja (4 milion lekë të vjetra). Kjo do të jepet për tre vitet e para ndaj një organizate jofitimprurëse. Dua të pyes: Sa e rëndon kjo shifër buxhetin e bashkisë? A nuk do të mund të përdorej kjo shumë për shërbime të tjera për qytetarët, të cilët shpesh kërkojnë ndihmë për hallet e tyre në këtë bashki? A është bërë një analizë se si do të ndikojë kjo kosto në investimet dhe shërbimet tona qytetare pas tre vitesh? A ka pasur konsultime paraprake me grupet e interesit për këtë nismë? Edhe pse shuma prej 4 milion lekësh mund të duket e vogël, ajo mund t'u hiqet shërbimeve thelbësore për qytetarët. Si do të përfaqësohet Bashkia Kurbin? Ju përmendët se do të ketë një përfaqësues nga bashkia. Si do të sigurohet transparenca e këtij përfaqësimi, në mënyrë që ne si qytetarë të jemi të informuar plotësisht? A është parashikuar nga Bashkia Kurbin ndonjë mekanizëm i posaçëm për të monitoruar performancën e TALGA-s dhe ndikimin e saj në administratën vendore? Si do ta matim suksesin e kësaj akademie? Dëshiroj të di më shumë rreth efekteve pozitive që kjo akademi do të sjellë për qytetarët tanë. Gjithashtu, a janë marrë parasysh efektet negative të mundshme? Për mua, një nga rreziqet kryesore është centralizimi i autonomisë së bashkisë. Krijimi i një njësie të tillë mund të mbivendoset me projekte të tjera ekzistuese dhe t'i heqë bashkisë autonominë që duhet të ketë në fushën e trajnimeve. Faleminderit!

Majlinda Cara, kryetare e bashkisë: Pyetja e parë, nëse e mbaj mend drejt, ishte kush përfaqëson dhe si përfaqësohet Bashkia Kurbin. Përgjigjja është se përfaqësohet nga kryetari i bashkisë. Këshilli autorizon kryetarin e bashkisë si anëtar të kësaj akademie. Për të gjitha

vendimet që do të merren në asamblenë e kësaj TALGA, pas regjistrimit të saj si organizatë në gjykatë dhe pas kalimit të procedurave ligjore, kryetari i bashkisë mund të raportojë në mbledhjet e ardhshme të këshillit për vendimet e marra dhe mënyrën e funksionimit. Por, duhet theksuar se vendimet i merr asambleja dhe këshilli drejtues. Në marrëveshjen dhe në aktin e themelimit përcaktohen qartë detyrat dhe kompetencat e secilës bashki, anëtarit të këshillit, drejtuesit ekzekutiv, bordit drejtues dhe asamblesë së përgjithshme. Sot jemi vetëm për autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes me ministrin për pushtetin vendor; nuk jemi në fazën e vendimeve me efekte financiare apo të tjera. Pas regjistrimit të organizatës, atëherë vijmë në këshill dhe raportojmë për hapat e mëtejshëm. Pika tjetër: besoj se ishin tre elementë kryesorë, të cilët lidhen me ndihmën apo ndikimin tek komuniteti. Stafit dhe administratës së bashkisë janë pjesë e këtij komuniteti, prandaj nevoja për trajnime dhe përgatitje profesionale është e menjëhershme, që të jemi transparentë dhe në shërbim të qytetarëve. Edhe pa krijuar këtë strukturë, bashkia mund të krijonte vetë një person juridik dhe t'i kërkonte këshillit buxhet për trajnime në institucione apo organizata të tjera. Deri tani kemi marrë disa trajnime, por nuk kanë qenë të fokusuara drejtpërdrejt në atë që na nevojitet për t'i shërbyer qytetarëve. Për këtë arsye, në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive, ku bëjnë pjesë 61 bashkitë, është ngritur si kërkesë e kryetarëve të bashkive që të krijohet një mundësi më e mirë dhe më efektive trajnimi për administratat tona. Kjo është kërkuar nga ne dhe është autorizuar nga Këshilli i Ministrave përmes ministrit. Besoj se për qytetarët kjo nuk përbën negativitet, sepse përfitojnë edhe nga vetë këshillat e trajnimeve, të cilët kanë buxhetin e tyre. Ju vetë keni qenë prezent në disa prej këtyre trajnimeve.

Aida Skeja, këshilltare: Gjithsecili nga ne, patjetër, kërkon një rritje të performancës për atë kohë sa është në punë dhe ka një detyrë të caktuar. Por, lidhur me këtë, mendoj se do të ishte më e udhës të bëhej një analizë më e qartë mbi riskun financiar që kjo nismë sjell.

Majlinda Cara, kryetare e bashkisë: Buxheti nuk ka ende kuota të përcaktuara, por do të ketë një përllogaritje që do të miratohet në asamblenë kur të krijohet TALGA. Patjetër që çdo anëtarë do të ketë një kuotë, e cila do të llogaritet në bazë të numrit të popullsisë. Kjo kuotë do të jetë minimaliste; për shembull, edhe 400.000 lekë të reja janë një buxhet minimal që ne mund të ofrojmë. Ky buxhet parashikohet për trajnimin e gjithë nëpunësve civilë dhe të gjithë administratës së bashkisë, duke filluar nga kryetari dhe deri tek këshilltarët. Ndryshe nga më parë, kur kompetencën për trajnimet e kishte ASPA, e cila ishte jashtë funksionit të bashkisë, tani me këtë krijim bashkia fiton kompetenca të plota. Kjo do të thotë se bashkitë do të jenë pjesë e trajnimeve të stafit të tyre dhe do të kenë mundësi t'i kontrollojnë ato. Deri tani, stafet tona trajnoheshin nga ASPA, por ne nuk kishim të drejtë të kontrollojmë sa trajnime morën, si u zhvilluan apo ku shkoi buxheti. Sot, bashkitë marrin kompetencat për ta kontrolluar këtë proces. Kjo është një gjë e mirë dhe shpreh një garanci më të madhe.

Aida Skeja, këshilltare: Pra, akademia TALGA nuk duhet të duplikohet, megjithëse ekziston mundësia që kjo të ndodhë. Për këtë arsye unë jam skeptik, sepse shpeshherë mungojnë mekanizmat përkatës që të na garantojnë funksionimin e saj. Ne, si përfaqësues bashkish, nuk

kemi pozicion vendimmarrës në asamblenë e akademisë, por vetëm rolin e dhënies së mendimeve apo pjesëmarrjes në dëgjesa. Dhe pikërisht për këtë arsye shpesh mungon mekanizmi që siguron vlefshmërinë dhe stabilitetin e strukturës. Një ndër pikat që mua më bëri të mos jem plotësisht dakord me këtë projektvendim është ajo që lidhet me vendimmarrjen për shkarkimin e anëtarëve të bordit drejtues. Në dokument, thuhet se edhe nëse 2/3 e asamblesë vendosin për shkarkimin e një anëtari, është përsëri ministri ai që ka fjalën e fundit, duke vendosur “po” ose “jo”. Kjo do të thotë se, edhe kur shumica vendos, një person i vetëm mund të bllokojë vendimin duke thënë: “Jo, vendos unë si dua.” Pikërisht kjo më krijoi idenë se kemi të bëjmë me një kufizim të autonomisë së bashkive dhe një mbivendosje të kompetencave të ministrit mbi to.

Majlinda Cara, kryetare e Bashkisë: Ke keqkuptuar aktin e themelimit. Ky akt sot është vetëm për njohje nga këshilli bashkiak dhe jo për miratim përfundimtar. Në të ardhmen, mund të ketë ndryshime të caktuara, por sot jemi në fazën e autorizimit të kryetarit të bashkisë për të qenë anëtar i TALGA-s dhe për të firmosur marrëveshjen. Më pas, nëse kryetarët e bashkive e kërkojnë, pika të caktuara të marrëveshjes mund të ndryshohen ose jo. Aktualisht, Këshilli i Ministrave ka autorizuar ministrin e pushtetit vendor që të lidhë marrëveshjet me bashkitë. Në të njëjtën mënyrë, këshillat bashkiakë të të gjitha bashkive autorizojnë kryetarët e tyre për firmosjen e marrëveshjes. Ministria e Pushtetit Vendor është rregullatori i bashkive – dhe kjo është pikërisht ajo që bashkitë vetë kanë kërkuar. Ne jemi shumë falënderues për krijimin e kësaj ministrie, sepse prej vitesh nuk kemi pasur një strukturë të tillë që të ndjekë problematikat e pushtetit vendor. Një nga nevojat më të mëdha ka qenë trajtimi i projekteve dhe fondeve. Shpeshherë kemi marrë kërkesa, ndihma apo fonde nga organizata dhe donatorë të huaj, por nuk kemi pasur staf të trajnuar për t’i përballuar. Për shembull, për aplikimet në fondet e Bashkimit Europian, Bashkia Kurbin nuk ka sot një staf të mirëtrajnuar. Kemi marrë disa projekte, por gjithmonë me ndihmën e ekspertëve të jashtëm. Ndërkohë, fondet e BE-së (si programet IPA që hapen çdo vit) janë të shumta dhe ne rrezikojmë t’i humbasim për shkak të mungesës së stafit të kualifikuar. Prandaj është e domosdoshme që pushteti vendor të ketë një strukturë të mirëtrajnuar, që të mund të aplikojë vetë dhe të përfitojë projekte e fonde në ndihmë të komunitetit. Kjo nuk është një nismë e ministrit, por një kërkesë e vetë bashkive.

Aida Skeja, këshilltare: Atëherë nëse s'ka rrezik mbi vendosje kompetencash patjetër që është mirë.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Kush është dakord? Kundër? Miratohen me shumicë votash atëherë.

Projektvendimi u miratua me 18 vota pro, 0 vota kundër dhe 0 abstenime. Nuk u paraqitën kërkesa për diskutim apo për argumentim të votës kundër.

4. Projekt vendim për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Kurbin 2025-2029 dhe projekt vendim për miratimin e Planit të Arsimit Parashkollor 2026-2028

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Kemi projektvendimin tjetër për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Kurbin 2025-2028 si dhe planin e Arsimit parashkollor 2026-2028. Ju lutem administrata.

Jurgena Tuci, Drejtorja e Burimeve Njerëzore: Atëherë kemi dhe një projektvendim tjetër, i cili është për miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Kurbin për vitin 2025-2028. Ky projektvendim, ose më mirë ky plan, është hartuar në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore, me Kodin e Procedurave Administrative, ligjin për nëpunësin civil, standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, si dhe ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

Disa nga objektivat kryesore të këtij plani janë: pasurimi i kuadrit strategjik të institucionit të bashkisë, promovimi i vlerave të mirëqeverisjes, rritja e besimit të qytetarëve tek institucioni, sigurimi i shërbimeve cilësore për komunitetin dhe garantimi i një niveli sa më të lartë dhe optimal të transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, një ndër objektivat është edhe përfshirja dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e bashkisë. Ky plan, si të thuash, është shumë i domosdoshëm, sidomos në krijimin e një terreni transparent, duke krijuar më shumë mundësi dhe duke qenë më transparent si bashki, veçanërisht në menaxhimin e burimeve njerëzore, në prokurimet publike dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Të gjitha këto, edhe pse i kam paraqitur në relacion, po i theksoj shkurtimisht për rëndësinë e Planit të Integritetit. Ky plan synon forcimin e integritetit institucional, parandalimin e korrupsionit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Duke përmirësuar etikën dhe integritetin në administratë, plani ndihmon në ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe të besueshme për qytetarët e Kurbin.

Gjithashtu, plani synon ndërveprim më të mirë me publikun. Me rritjen e transparencës dhe ndërveprimin me publikun, ndihmohet në krijimin e një marrëdhënieje më të fortë dhe më të besueshme ndërmjet Bashkisë dhe qytetarëve. Një element tjetër i rëndësishëm është menaxhimi i riskut, pasi duke përfshirë menaxhimin e riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë, plani siguron një qasje proaktive për identifikimin dhe trajtimin e risqeve të mundshme përpara se ato të bëhen më të mëdha dhe problematike. Në këtë kuadër, kërkoj miratimin e këshillit për miratimin e këtij plani. Nuk e di, nëse keni pyetje, jemi të hapur për diskutim. Faleminderit! Gjithashtu, dua të theksoj se ky plan nuk është hartuar vetëm nga bashkia, por mbi bazën e dispozitave ligjore dhe me kontributin e ekspertëve të jashtëm.

Albert Ndoci, Këshilltar: Tash mirëdita njëherë të gjithëve. Edhe fjala integritet për Bashkinë e Kurbin, për mendimin tim, nuk bëhet fjalë që duhet diskutuar për integritet; gjithçka mund të ketë, vetëm integritet nuk ka. Si ka mundësi që paska integritet Bashkia e Kurbin, kur unë ka 40 vjet, me Partinë e Punës të Shqipërisë, kam ndërtuar në qytetin e Laçit me të gjitha këto rregulla, por vjen Bashkia e Kurbin dhe më prish një portë dhe më shkatërron 180 vazo lulesh dhe 15

pemë? Si mund të flitet për integritet për këtë bashki, kur kjo bashki, duke filluar nga toka dhe deri në bregdet, është komplet e paligjshme dhe me ndërtime pa leje? Asnjë gjë nuk funksionon: ndërtime pa leje, vetëm me saj të shpërblimeve dhe ryshfeteve. Si mund të flitet për integritet për këtë bashki? Si mund të flitet kur para shtëpisë time janë të rreshtuar pallatet, krejt një për një, dhe vijnë të gjithë këshilltarët, si delet, sipas mendimit tim, si nga pozita, ashtu edhe nga opozita? Kur ka dëme të mëdha, askush nuk vjen; një për një merren vetëm me interesat mesquine, interesa koti. Ata kanë prishur Bashkinë Kurbin, një vepër që ka qenë vepra më mirë që ka pasur, me miliarda lekë, e ndërtuar me të gjitha rregullat, dhe e prishën pa asnjë reagim. Për shembull, një pallat para Bashkisë Kurbin, pranë Shkollës së Mesme “Kurbin”, që ka 60 familje; impresion nga më të ndryshmet. Sipas mendimit tim, këta janë dele. Duhet të jesh Aslan apo Skënderbe për ta kuptuar. Ta keni të qartë: ujët e zi, madje edhe nëse më vrisni pa dalë nga kjo bashki, kam për t’ua nxirë jetën me denoncime, sa te Kryeministri, sa te SPAK-u. Nuk kam për të harruar deri në ditën e vdekjes sime. Ftoj një për një këshilltar bashkiak: nuk janë burra, asnjë nuk është burrë, as burrë as grua; të vijnë para shtëpisë time, ke kënda, hajde ke një vepër. Këtë situatë e kam të dokumentuar: nga Miloti, nga Selita, nga qendra e Laçit, nga Patoku – gjithçka e di dhe kam 20 dosje të gatshme me fakte. Faleminderit!

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Ju lutem, këshilltarëve, të rrini brenda rendit të ditës. Tani, zoti këshilltar, ky diskutim që po bëni nuk është pjesë e kësaj pike. E kam fikur mikrofonin, pasi nuk ishte pjesë e rendit të ditës. Nuk mundesh, i nderuar këshilltar, të na akuzosh, të akuzosh këshilltarët; nuk ke të drejtë. Çfarë jemi ne, i nderuar këshilltar? Akuza ndaj këshilltarëve të tjerë nuk mund të bëhen në këtë mënyrë. Jo, nuk mund ta bësh në këtë mënyrë ti; asnjë nuk mund ta ofendojë ashtu siç flet ti. Nuk është etike fare për ne. Jo tani; nuk ke të drejtë, z. Albert. Fjala jote mbaroi. Është e drejta jote, por jetën tonë nuk e nxin dot ti. Ti vazhdo me instancat përkatëse.

Anton, doje fjalën? Po, mund të vazhdosh, Anton.

Anton Kolziu, këshilltar: Përshëndetje të gjithëve. Me sa duket, ne jemi në një sallë të nderuar ku janë gjithë përfaqësues të popullit, dhe nuk jeni në një stalle delësh. Çuna, dele apo dhije, keca. Problemi i dytë është: pse ky projektvendim vjen me kaq vonesë? Nuk ka pasur kohë për ta ardhur me zafin, kur kanë ardhur materialet e tjera.

Majlinda Cara, kryetare e Bashkisë: Po i kthej unë përgjigjet, po Anton, me shumë të drejtë ke këtë pyetje. Për shkak se ne ishim në përgatitje bashkë me ekspertët për këtë plan të integritetit të bashkisë, gjej rastin ta falenderoj Hekuranin, që ka qenë një ndër bashkëpunëtorët kryesorë në hartimin e këtij plani. Në fakt, plani ishte për t’u miratuar në mbledhjen e radhës së këshillit bashkiak në shtator, por duke qenë që na erdhi një shkresë nga ministria se këto plane duhet të miratohen para datës 17 shtator, pamë të arsyeshme që t’i drejtohemi këshillit për miratim.

Plani i integritetit është një plan që i vendos detyra bashkisë dhe është një plan që kontrollohet edhe nga këshilli bashkiak. Disa pika të tij e bëjnë administratën të forcojë më shumë integritetin dhe, më shumë sesa ne në këtë sallë, këshilli duhet të jetë garanci e integritetit. Po ashtu, ne si administratë e kemi të pamundur të vijmë në një sallë ku ka emrin e madh të qytetarëve dhe të

diskutohet, të flitet si të jesh në një sallë ku shumica e ndoshta e këtij komuniteti... dhe mua më vjen turp të vij më me këshilltarë që marrin fjalën në këtë mënyrë, si zoti Bert Noci.

Të lutem, të dëgjova me shumë kujdes. Më vjen turp, dhe e nderuara drejtuese e seancës, jashtë rendit të ditës, nëse ka këshilltarë që flasin jashtë rendit të ditës, duhet të veprohet sipas rregullores së miratuar në këshill.

Ky monumenti i kulturës i komunitetit të Bashkisë Kurbin. Shtëpia e këtij privati është, si gjithë shtëpitë e ndërtuara në Kurbin, prej shumë ditësh, por nuk lejohet, jo këshilltarit, por asnjë qytetari të zëjë hapësirën publike, e cila është një hapësirë e përbashkët për të gjithë qytetarët. Edhe zoti këshilltar është njoftuar mbi sanksionin për hapësirat publike, pas ankesave të qytetarëve dhe banorëve të pallatit, ku janë ngjitur me shtëpinë e këtij privati. Edhe një pallat i tërë dhe një lagje e tërë kanë rrethuar të gjithë hapësirën publike. IMT-ja, bazuar në ligjin për kompetencat e veta, dhe policia bashkiake kanë bërë njoftimet në bazë të ligjit. Në mungesë të përgjigjes vullnetare, janë marrë të gjitha masat për lirim të kësaj hapësire nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, policia bashkiake dhe policia e shtetit. Pra, kemi të bëjmë me një shkelës të ligjit, i cili pretendon që këtij komuniteti t'i thotë: "Unë jam zëri juaj në këshillin bashkiak." Ky është Bert Ndoci, ky është ai që flet. Për mua, është turp të relatoj si bashki para një këshilltari pa integritet si ky njeri, i cili duhet t'u kërkojë falje publike qytetarëve që e kanë votuar për të qenë këtu në këshillin bashkiak.

Shumë faleminderit për të gjithë komentet, edhe për gjithë ato që tha Antoni. Ishim përgatitur bashkë me Hekuranin, kemi punuar këto dy ditë fort, edhe me orar të zgjatur, për ta sjellë planin në këshill. Këto plane kanë, përveç aspekteve pozitive që ndiqen nga pushteti vendor, edhe pika që administrata duhet t'i pranojë me rigozitet. Pra, ato janë kontrolle mbi administratën. Qeveria për këtë vit ka kërkuar nga bashkitë hartimin e disa planeve si pjesë e performancës së bashkisë. Hartimi i planeve është një lloj performance bashkie, dhe nëse dokumentacioni i plotë dhe i rregullt miratohet nga Ministria e Pushtetit Vendor, bashkia bëhet edhe përfitues e një grandit. Dje, në dëgjesat publike, këshilltarja Aida ka qenë prezent, Albana besoj po ashtu. Kanë qenë qytetarë, administratë, mësues dhe pjesëmarrës nga fusha të ndryshme. Në këto dëgjesa janë sqaruar të dy planet që kërkojnë miratimin sot, dhe shpresojmë fort që, dorëzimi i tyre në Ministrinë e Pushtetit Vendor do të sjellë grantin që mund të përdoret për investime në shërbim të qytetarëve.

Pashk Prenga, këshilltar: Tani, përshëndetje të gjithëve. Procedurat, nuk ka arsye kurrë në botë të fyhet integriteti i secilit prej nesh, asnjë prej nesh. Secili ka integritetin e vet, ka pronën e vet, ka shtëpinë e vet, dhe për çdo paqartësi ka instanca shtetërore që mund t'i zgjidhë vetë. Në qoftë se bashkia ka bërë diçka të paligjshme, qytetari ka mundësinë të shkojë dhe ta denoncojë në organet përkatëse që janë të ngarkuara për këtë punë. Nuk ka arsye të vijë dikush dhe të shprehë mërzinë e vet duke ofenduar të gjithë kolegët e këshillit këtu. Një person që ka një hall të vetën, nuk do të thotë se ka të drejtë të trajtojë si padrejtësi të gjithë të tjerët. Ky është rasti i fundit që më ndodhi mua këtu, sepse ndoshta ndonjë nga ne mund ta kthejë në personale me çështje që nuk lidhen me të tjerët. Edhe në raste personale nuk ka mundësi të thyhet integriteti i secilit prej nesh. Secili ka mandatin e vet, ka përfaqësimin e vet, përfaqëson elektoratin e vet. Ai ka elektoratin e vet, bravo qoftë, po jo me këtë model. Unë kam elektoratin tim, një model tjetër; ai ka elektoratin e vet, një model tjetër. Unë nuk di kush ka votuar këtë lloj modeli këshilltari, që vjen dhe

ofendon pa respekt dhe del jashtë formateve të duhura. Ndoshta ka emocione, por emocione duhet të kontrollohen. Çdo këshilltar duhet të kontrollojë emocionin e vet dhe të veprojë me profesionalizëm.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Është e rednësishme që të ruajmë integritetin tonë. Të gjithë kemi halle personale. Diskutime të tjera?

Aida Skeja, këshilltare: Shikoni, unë nuk zgjatem shumë kur bëhet fjalë për projekte që kanë të bëjnë me përthithjen e granteve për komunitetin tonë. Ky është një projekt për arsimin. Unë isha edhe në dëgjuesën e ditës së djeshme, që u zhvillua këtu në një nga sallat e bashkisë. Është një projekt që, së pari, dua të përgëzoj stafin që e ka hartuar, pra Drejtorinë e Arsimit pranë bashkisë, të cilët kanë punuar dhe kanë realizuar hartimin e projektit. Ne shkojmë me këtë projekt pranë Ministrisë së Arsimit, si një kërkesë edhe të bashkisë sonë, për të përfituar mbështetje për këtë projekt. Për këtë arsye, nuk besoj se ka vend për komente të gjera. Çështjet janë diskutuar edhe dje gjatë dëgjuesës për planin afatmesëm 2026-2028 për arsimin pauniversitar. Mendoj që, të gjithë së bashku, për shkak edhe të kohës që është e kufizuar, të kalojmë këto dy projektvendime në votim pa zgjatje të mëtejshme.

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Atëhere hedhim në votim dy projekt-vendimet për planet. Kush është dakord? Kundër? Miratohen.

Projektvendimet u miratuan me 18 vota pro, 0 vota kundër dhe 0 abstenime. Nuk u paraqitën kërkesa për diskutim apo për argumentim të votës kundër.

Pra miratohen të dy planet .

Marjana Gjini, kryesuese e mbledhjes: Duke ju falenderuar për praninë dhe duke ju kërkuar ndjesë në emër të Këshillit Bashkiak për situatën e krijuar, do t'ju njoftojmë për hapat që do të ndërmerren.

Deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Sekretari i Këshillit

Arber LEKA